



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-CC-PR-2020-09

**Vendos:** Kryetari i panelit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës  
Kushtetuese  
Gjykatës Vidar Stensland

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 7 maj 2020

**Gjuha:** anglishte

**Titulli i dosjes:** Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të  
Provave në pajtim me nenin 19(5) të ligjit

**Klasifikimi:** publike

---

**Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në lidhje  
me referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të  
Provave**

---

**Kryetares së Dhomave të Specializuara të Kosovës**  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

1. Më 29 dhe 30 prill 2020, në mbledhjen e tyre plenare, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës miratuan ndryshime të Rregullores së Procedurës dhe të Provave Para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").<sup>1</sup> Gjykatësit kushtetues nuk morën pjesë në miratimin e tyre.
2. Më 1 maj 2020, Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, në pajtim me nenin 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji")<sup>2</sup>, ia referoi ndryshimet e lartpërmendura Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma")
3. Në të njëjtën ditë, në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi një panel të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ndryshimeve në Rregullore, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe nenin 55 të saj.
4. Neni 3(8)(c) i Ligjit përcakton se, për arsye të administrimit të duhur të drejtësisë ose të sigurisë, Kryetari i panelit të Dhomës mund të kërkojë caktimin e vendit të zhvillimit të procedurave në shtetin pritës. Kryetari i panelit gjykon se administrimi i duhur i drejtësisë kërkon caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në fjalë në shtetin pritës, përkatësisht në Holandë.

---

<sup>1</sup> KSC-CC-PR-2020-09, F00001, Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik me shtojcë konfidenciale, 1 maj 2020.

<sup>2</sup> Po aty.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARI I PANELIT TË DHOMËS SË  
SPECIALIZUAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE

*Kërkon* ndryshim të vendit të zhvillimit të procedurës në lidhje me procedurën aktuale  
para Dhomës, që merr shkas prej referimit të ndryshimeve të Rregullores.

\_\_\_\_\_/nënshkrim/\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Gjykatës Vidar Stensland**

**Kryetar i panelit**

Hartuar në anglishte, e enjte, 7 maj 2020

Në Hagë, Holandë